



Universiteti "Isa Boletini", Mitrovicë

Zyra për Sigurim të Cilësisë

RAPORT PËRMBLEDHËS PËR PYETËSORËT E REALIZUAR ME ALUMNI

Tetor, 2022

Përmbajtja

Lista e shkurtesave	3
Hyrja	4
Zyra për Sigurim të Cilësisë (ZSC)	5
Realizimi i pyetësorit	6
Gjetjet e pyetësorit	7
Rezultatet	8
Rekomandimet	12

Lista e shkurtesave

IAL:	Institucion i Arsimit të Lartë
KQSCV:	Komisioni Qendror për Sigurimin e Cilësisë dhe Vlerësimin
SEVC:	Sistemi Elektronik për Vlerësimin e Cilësisë
SMU:	Sistemi i Menaxhimit Universitarë
UIBM:	Universiteti “Isa Boletini”, Mitrovicë
ZSC:	Zyra për Sigurim të Cilësisë



Hyrja

Universiteti “Isa Boletini”, Mitrovicë (këtu e tutje: UIBM), si Institucion i Arsimit të Lartë (Këtu e tutje: IAL) themeluar që nga viti 2013, vazhdimisht ka bërë përpjekje që të bëjë të matshëm procesin e sigurimit të cilësisë. Për çdo vit, në UIBM janë organizuar pyetësorë me studentët dhe akterë tjerë relevant, të cilët janë përgjigjur në pyetjet të cilat kanë pasur për qëllim të tregojnë gjendjen reale në UIBM përmes perceptimit të respondentëve.

UIBM ka mekanizmat e tij për matjen e cilësisë, dhe përveç që procesi matet dhe monitorohet në vazhdimësi nga ana e dekanëve, prodekanëve, koordinatorëve për cilësi në kuadër të fakulteteve, Zyra për Sigurim të Cilësisë në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (Këtu e tutje: ZSC) ka një rol të veçantë në këto zhvillime, dhe është organi kryesor brenda UIBM për matjen e cilësisë së brendshme.

I gjithë procesi, i hartimit të pyetësorëve, lansimit të tyre dhe i mbledhjes së të dhënave është bërë nga ZSC-ja në koordinim të plotë me KQSCV-në. Procesi është transparent, dhe të gjithë pyetësorët kanë janë anonim duke respektuar kështu dinjitetin e secilit respondent dhe duke ruajtur prestigjin e institucionit, përjashtimisht pyetësorët e vetëvlerësimit.

Me qëllim që raporti të ruaj etikën e secilit dhe atë të institucionit, do të gjeni të publikuara vetëm disa nga gjetjet kryesore të pyetësorëve. Rekomandimet si pjesa e fundit e tij, do të përmbajnë edhe sugjerime e vërejtje të cilat nuk bëhen publike, por që janë dhënë nga ana e respondentëve.

Zyra për Sigurim të Cilësisë (ZSC)

Zyra për Sigurim të Cilësisë është zyrë e pavarur e cila funksionon brenda Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (tutje UIBM) e cila raporton drejtpërdrejt te Rektori i UIBM-së. ZSC angazhohet në rritjen e cilësisë në UIBM duke zbatuar të gjitha politikat institucionale dhe instrumentet matëse të cilësisë të aprovuar nga Komisioni Qendror për Sigurimin e Cilësisë dhe Vlerësimin (tutje KQSCV). Zyrtarët e cilësisë nuk janë pjesë e stafit akademik të UIBM-së.

Zyra kryen matje të cilësisë duke përdorur të gjitha instrumentet e përfshira në pakon e instrumenteve matëse të cilësisë e aprovuar nga KQSCV. ZSC harton raporte që përmbajnë gjetje dhe rekomandime për secilën pyetësor të realizuar të cilët i dërgon te Rektori i UIBM-së. Zyra gjithashtu i dërgon gjetjet dekanëve të njësive akademike me qëllim të planifikimit të zhvillimit të stafit akademik dhe përmirësimit të vazhdueshëm.

Realizimi i pyetësorit

Pyetësori me studentët ALUMNI është një pyetësorë që realizohet një herë në vit në koordinim me Asociacionin ALUMNI dhe të gjitha njësite akademike përmes koordinatoreve për cilësi.

Pyetësori me studentët ALUMNI është realizuar gjatë periudhës 30.09.2022 - 14.10.2022 dhe në të janë përgjigjur 259 të diplomuar. Pyetësori ka qenë anonim dhe të dhënat janë mbledhur dhe ruajtur nga ZCS. Studentët ALUMNI janë përgjigjur përmes telefonit në një intervistë të shkurt. Pyetësori ka përmbajtur 7(shtatë) pyetjet të mbyllura dhe 1(një) pyetje të hapur, ku kanë vlerësuar studimet, përgatitjen e studenteve, njohurit dhe bashkëpunimin me UIBM, etj.

Pyetjet kanë pasur për qëllim që të shohin këto aspekte kryesore:

- Përgatitjet për karrierë;
- Aftësitë dhe shkathtësitë e fituara;
- Plan-programi i studimeve;
- Bashkëpunimi me UIBM edhe pas studimeve;
- Përshtypjet për UIBM;
- Sugjerimet dhe komentet.

Gjetjet e pyetësorit

Nga të gjeturat, studentët ALUMNI kanë qenë të sinqertë në përgjigjet e tyre, dhe kemi pranuar shumë komente dhe sugjerime që tregojnë interesimin e tyre që të kontribuojnë në proceset në UIBM-së. Ky raport shprehë vetëm statistikat e përgjithshme, dhe rekomandimet që dalin nga tërësia e përgjigjeve të marra.

Studentët ALUMNI kanë vlerësuar se studimet që kanë ndjekur i kanë përgatitur mirë për karrierën e tyre duke ju ofruar mundësi për të fituar aftësi dhe njohuri të reja në mënyrë të pavarur.

Studentët ALUMNI kanë vlerësuar se shkathtësitë dhe njohuritë e fituara janë në gjendje të i aplikojnë në punët e tyre që janë angazhuar. Pjesë për tu trajtuar është pjesa e lëndëve zgjedhore e cila duhet të shikohet nga njësite akademike për të ju ofruar lëndë zgjedhore më të nevojshme për punë.

Studimet janë vlerësuar se kanë dhënë efektin e tyre në përgatitjen e studentëve dhe ata përfaqësojnë vlerat e UIBM-së në punën e tyre.


UIBM përmes Asociacionit ALUMNI i mbanë të informuar për shpalljet për vendet e lira të punës, konferenca, ngjarje, seminare, trajnime, si dhe ligjërata publike me qëllim të avancimit profesional por që në këtë pjesë duhet të punohet edhe më shumë.

Asociacioni ALUMNI ua mundëson studentëve të mbajnë lidhjet mes tyre me qëllim të bashkëpunimit edhe pas përfundimit të studimeve.


Në përgjithësi të gjithë të anketuarit ALUMNI janë të kënaqur me UIBM dhe programet që kanë ndjekur dhe rekomandojnë të tjerët të ndjekin studimet këtu.

Rezultatet


1. A keni vazhduar studimet post-diplomike?




2. A keni bërë ose bëni punë praktike?




3. A jeni të punësuar?




4. Në cilin sektor jeni të punësuar ?




5. A jeni me kontratë të plotë apo të pjesshëm ?



6. A ju kanë ndihmuar studimet për të gjetur punë dhe apo ju ndihmojnë tani në punë ?



7. A do të kishit zgjedhur përsëri këtë program ?



■ Po ■ Jo

Rekomandimet

Zyra e cilësisë në UIBM, pasi që ka shqyrtuar përgjigjet e studentëve ALUMNI, në këtë fazë të zhvillimit të institucionit, i rekomandon menaxhmentit të lartë të UIBM që të merren hapat si më poshtë:

- Të fuqizohet edhe më tepër Asociacionin ALUMNI (përfshirë aspektin financiar për aktivitete të ndryshme).
- Zyra për zhvillim në Karrierë të jetë më aktive me rrjetin ALUMNI në ofrim të informatave për shpalljet për vendet e lira të punës, konferenca, ngjarje, seminare, trajnime, si dhe ligjërata publike me qëllim të avancimit profesional.
- Të ofrohen më shumë lëndë zgjedhore që lidhen direkt me fushën e studimit dhe profesionin.
- Të rritet numri i orëve për punë praktike.
- Laboratorët të jenë më të qasshme për studentë (të realizojnë eksperimente nën monitorim)
- Të arrihen sa më shumë marrëveshje me IAL-të tjera, vendore dhe ndërkombëtare për të mundësuar mobilitet të studentëve.